



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstva za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

Prishtinë, 11 shkurt 2016

Programi i bursave hungareze “Stipendium Hungaricum” për studentët kosovarë

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria për Kapacitete Njerëzore e Hungarisë kanë nënshkruar marrëveshjen e “Programit për Bashkëpunim Shkencor dhe Arsimor” për vitet 2016-2018. Sipas këtij programi të bashkëpunimit Qeveria e Hungarisë ofron gjithsej 30 bursa në vit për studentët e Kosovës, për të ndjekur studimet në Hungari në gjuhën hungareze apo në një gjuhë tjetër të huaj sipas kornizës vijuese përmes programit “Stipendium Hungaricum”:

- 10 bursa për 6 semestra të plotë të programeve të studimit BA/BSc në fushën e Bujqësisë,
- 5 bursa për 6 semestra të plotë të programeve të studimit BA/BSc në fushën e Gjuhës dhe Letërsisë Hungareze,
- 10 bursa për 4 semestra të plotë MA/MSc në fushën e Bujqësisë,
- 3 bursa për në fushën e Mjekësisë, dhe
- 2 bursa për studime të plota PhD nga fusha e ekonomisë, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe administrata publike.

Gjithësejt, 27 institucione hungareze të arsimit të lartë janë të angazhuar në Programin “Stipendium Hungaricum” për vitin akademik 2016/2017 me një total prej 420 programeve studimore. Programet studimore janë në përgjithësi në dispozicion në gjuhën angleze dhe hungareze, me disa programe poashtu të ofruara në gjuhën gjermane dhe frenge.

Në linkun më poshtë mund të gjeni listën e programeve studimore të ofruara:

<http://www.tka.hu.international-programmes/2966.stipendium-hungaricum/>

Bursa do të përshijë:

Pagesën e shkollimit – studentët lirohen nga pagesa e tarifës së shkollimit

Bursë mujore:

-niveli baçelor dhe master, c: HUF 40 460 mujore (cca 130 Euro) kontribut për shpenzimet e jetesës, për 12 muaj në vit, deri në përfundim të studimeve.

-niveli i doktoratës: sipas legjislacionit aktual të Hungarisë, për momentin është HUF 100 000 mujore (cca 325 Euro) – për 12 muaj në vit, deri në përfundim të studimeve – por legjislacioni pritet duhet të ndryshohet, dhe rrjedhimisht shuma pritet të ngritet.

Akomodimi: në konviktin e studentëve ose kontributi i HUF 30 000 për shpenzimet e akomodimit për gjithë kohëzgjatjen e periudhës së bursës.

Sigurimi mjekësor: shërbimet e kujdesit shëndetësor sipas legjislacionit relevant Hungarez (Akti no. 80 i vitit 1997, karta e sigurimit shëndetësor kombëtar) dhe sigurimi shtesë mjekësor.

Aplikacionet dhe të gjitha dokumentet relevante duhet të dërgohen on line në këtë link:

<http://www.tka.hu/international-programmes/2966/stipendium-hungaricum/>

dhe në zarf në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me këtë shënim:

Hungary's scholarship "Stipendium Hungaricum" application

Për: Znj. Hanëmsha Aliu-Latifi,

Udhëheqëse e Divizionit për Integritet Evropian – MASHT

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Zyra 103, Arkiva e Ministrisë

Email: hanemsha.latifi@rks-gov.net

Tel: +3813820020062

Nëse ju nevojiten më shumë informata sa i përket skemës së bursave, ju mund të kontaktoni pikën qendrore të Ministrisë për Bursat Hungareze "Hungaricum Stipendium";

Prof. Dr. Hysen Bytyqi

Këshilltar i Ministrit

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Tel: +38138213939 (20071)
Email: hysen.bytyqi@rks.gov.net

Aplikacionet mund të dërgohen deri më **16 mars**, rundi i parë i selektimit është në mars. Aplikantët do të informohen rreth rezultatit të raundit të parë të selektimit jo më vonë se **data 5 prill 2016**. Aplikantët do të informohen rreth rezultatit final të aplikimit jo më vonë se data **22 qershori 2016**.

Para fillimit të studimeve të arsimit të lartë në gjuhën hungareze, studentët do të marrin pjesë në një kurs përgatitor një vjeçar, i siguar nga pala hungareze në institucionet pritëse të arsimit të lartë. Studentët që aplikojnë për programet në gjuhë të huaj duhet të kanë një njohuri të duhur të asaj gjuhe në një nivel të caktuar që është definuar nga institucioni pritës. Bursa do të jepet pas kalimit me sukses të provimit pranues tek institucioni pritës.

Secili aplikant ka të drejtë për të aplikuar deri në tri programe të ndryshme studimi, sipas preferencës. Pas paraqitjes së aplikimit, radha e preferencës nuk mund të ndryshohet nga aplikuesi.

Aplikacionet do të konsiderohen si të pranueshme nëse aplikanti nominohet nga autoritetet përgjegjëse të partnerit dërgues, që është MASHT-i në Kosovë.

Aplikacionet nuk do të mirren parasysh në rastet vijuese:

- Për qytetarët hungarez (përfshirë ata me shtetësi të dyfishtë),
- Ish përfituesit mbajtësit e bursave "Stipendium Hungaricum", të cilët ri-aplikojnë për studime në ciklin e njëjtë të arsimit (p.sh. baçelor, master, doktoraturë),

Nëse keni pyetje të tjera, ju lutem mos hezitoni të kontaktoni Z. Tamas Gergely, diplomatin përgjegjës në Ambasadë:

Tamas Gergely
Sekretar i parë
Ambasada e Hungarisë
Prishtinë

Email: tamas.gergely@mfa.gov.hu
Tel: +381 38 247 763
Mob: + 386 49 744 055